



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
“PROCEDURAT E NDALIMIT OSE KUFIZIMIT TË PËRDORIMIT TË LIRË TË
AKTIVEVE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT”

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 20, datë 28.04.2015

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të ndalimit ose kufizimit të përdorimit të lirë të një pjese apo të gjithë aktiveve duke përfshirë dhe veprimtarinë që lidhet me dhënien e huave dhe investimeve, të shoqërisë së sigurimit.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të germës ë), pika 1, e nenit 153, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen ndaj shoqërisë së sigurimit, objekt i masave të mbikëqyrjes të vendosura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 4
Përkufizime

Për efekt të kësaj rregulloreje me termin “përdorim i lirë i një pjese apo të të gjithë aktiveve” do të kuptohet, përdorim i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, si dhe çdo aktiv dhe investim tjetër pasqyruar në pasqyrat financiare të shoqërisë së sigurimit.

Të gjithë termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në nenin 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 5

E drejta e Autoritetit për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të lirë të një pjese apo të të gjithë aktiveve të shoqërisë duke përfshirë dhe veprimtarinë që lidhet me dhënien e huave dhe investimeve

1. Autoriteti në rastet kur shkelen dispozitat e neneve 89-98,100, dhe 102-108, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhëron ndalimin ose kufizimin e përdorimit të lirë të aktiveve të shoqërisë së sigurimit. Autoriteti përcakton si datë të fillimit të ndalimit të përdorimit të lirë të aktiveve datën e marrjes së vendimit bordit.
2. Autoriteti njofton menjëherë shoqërinë për vendimin e marrë.
3. Autoriteti, në vendimin e tij përcakton afatet kohore për eliminimin e shkeljeve apo parregullsive.
4. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e shkeljeve të neneve 89-98,100, dhe 102-108, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, brenda afateve të përcaktuara nga Autoriteti. Së bashku me raportin shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet pasqyrat financiare dhe çdo dokument tjetër, në datën kur parashikohet eliminimi i shkeljeve apo parregullsive.

Neni 6

Lista e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike si dhe aktiveve të tjera të shoqërisë

1. Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet brenda 5 ditëve nga marrja njoftim për vendimin e Bordit të Autoritetit, listën e plotë të aktiveve pasqyruar në pasqyrat financiare si dhe listën e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe vlerat përkatëse për periudhën e përcaktuar në këtë vendim. Shoqëria e sigurimit me kërkesë të Autoritetit depoziton dhe të gjitha të dhënat/dokumentacionin që mund të përdoren për verifikimin e llogaritjes së aktiveve pasqyruar në pasqyrat financiare të saj.
2. Shoqëria e sigurimit depoziton gjithashtu listën analitike të llogarive ku mbahen depozitat, bonot e thesarit, obligacionet qeveritare, titujt e tjerë të borxhit, dhe llogaritë rrjedhëse që konsiderohen aktiv në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, me gjendjen e tyre, në datën e marrjes së vendimit të Bordit të Autoritetit.
3. Autoriteti u përcakton bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja në territorin e RSH si dhe Bankës së Shqipërisë listën e llogarive të shoqërisë së sigurimit ku mbahen depozitat, bonot e thesarit, obligacionet qeveritare, titujt e tjerë të borxhit, dhe llogaritë rrjedhëse, transaksionet me të cilat janë të ndaluara apo të kufizuara për shoqërinë e sigurimit.

4. Autoriteti u përcakton bankave dhe/ose degëve të bankave të huaja në territorin e RSH, si dhe Bankës së Shqipërisë llojet e transaksioneve që janë të ndaluara apo kufizuara me këto llogari.
5. Transaksionet me këto llogari të identifikuara sa më lart nuk mund të kryhen pa miratimin paraprak të Autoritetit.
6. Autoriteti urdhëron shoqërinë të ndalojë apo kufizojë dhënien e huave të pakolaterizuara, të kolaterizuara apo paradhëniet e tjera (për punonjësit, palë të lidhura, etj).
7. Shoqëria e sigurimit për çdo ndryshim apo lëvizje që ndikon në rënien e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike si dhe në rënien e çdo aktivi tjetër të shoqërisë, përveç rasteve të pagesave të dëmeve, duhet të depozitojë në Autoritet kërkesën ku shpjegohen arsyet e këtyre lëvizjeve, si dhe dokumentacionin justifikues. Kërkesa mund të depozitohet edhe në mënyrë elektronike në adresën e Autoritetit (amf@amf.gov.al).
8. Autoriteti miraton ose refuzon kërkesën e përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës nga shoqëria e sigurimit.

Neni 7

Mbikëqyrja

1. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e këtij procesi.
2. Autoriteti mund të kryejë inspektim rast pas rasti për çështje të veçanta që lidhen me procesin e ndalimit ose kufizimit të përdorimit të lirë të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe aktiveve të tjera të shoqërisë.
3. Autoriteti në përfundim të afateve informon Bordin, nëse shoqëria e sigurimit ka eliminuar shkeljet duke respektuar dispozitat e neneve 89-98,100, dhe 102-108, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 .

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.